

TE EDUKOJME FEMIJET PËR NJE SJELLJE TE SIGURTE NE RRUGE.

Pjesa më e madhe e aksidenteve rrugore e ka shkakun në gabimet e njerëzve, pra të përdoruesve të ndryshëm të rrugës. Për këtë arsye masat për rritjen e sigurisë rrugore, përveç të tjerave dhe në radhë, synojnë të ndryshojnë qëndrimet dhe sjelljet e përdoruesve të rrugës.

Mos harrojmë aksidentet me kalimtarët llogariten për 34% të të vrarëve në rrugë.

Pikërisht për këtë arsye, një ndër objektivat e punës për përmirësimin e sigurisë rrugore në të ardhmen do të synojë në ndryshimin e këtij qëndrimi, sepse shumë përdorues të rrugës nuk janë sa duhet të vetëdijshëm për rreziqet që paraqet rruga.

Që kjo punë të jetë sa më e efektshme dhe të krijojë që në fillimet e saj qëndrimet dhe sjelljet e dëshiruara nga pikëpamja e rritjes së sigurisë rrugore është e rëndësishme që ajo të fillojë që në moshat e vogla shkollore.

Është e domosdoshme që të ngulisim tek fëmijet të dallojë rreziqet kryesore në rrugë, të njohë sjelljet e rrezikshme në rrugë dhe ato të sigurt; të përshkruajë mënyrën e sigurt të përdorimit të biçikletës, të patinave etj. në rrugë dhe në mjedise publike, të dallojë disa nga shenjat që rregullojnë lëvizjen e tyre si këmbësorë në rrugë dhe në parqe publike.

Ecja është kaq natyrale që më të shumtën e kohës këmbësorët nuk janë të ndërgjegjshëm që edhe ata janë përdorues të rrugës. Për këtë arsye ekzistojnë rregullat.

Pjesa më e madhe e aksidenteve në radhët e fëmijëve ndodhin kur këta duhet të kalojnë rrugën. Ata shpesh herë harrojnë të ndalojnë përpara se të kalojnë ose nuk shohin në të dy drejtimet e rrugës.

Edhe nëse ata e bëjnë një gjë të tillë, pra shohin mirë në të dyja drejtimet përpara se të kalojnë rrugën përsëri ata mund të bëhen viktimat e automjeteve pasi ata shpesh herë shpërfillin automjetet që lëvizin në pjesën e rrugës që është më larg. Sidoqoftë, fëmijët në më të shumtën e rasteve shohin vetëm në një drejtim.

Kur fëmijët mësojnë të përdorin sinjalizimet e trafikut dhe ata e dinë se drita e kuqe “të thotë” *Ndal!* dhe drita jeshile “të thotë” *Kalo!*, ata kanë besim të verbër në dritat e trafikut. Shumë prej fëmijëve kanë pësuar aksidente edhe pse ata e kanë kaluar rrugën në kohën e duhur, me dritën jeshile që i jep përparësi këmbësorit. Kjo ndodh pasi automjetet që lëvizin në kthesë, mund të mos i shohin ata.

Aksidentet që ndodhin më shpesh janë ato që shkaktohen nga kalimi i papritur i fëmijëve në rrugë, pa parë ose u siguruar më parë se ku po shkojnë. Si rregull, pranohet fakti që fëmija nuk është në gjendje të kontrollojë të gjitha impulset e tij, veçanërisht në rastet kur ndodhin ngjarje të reja, interesante ose nxitëse për ta. Kur fëmijët luajnë, ata nuk kujtohen për rregullat e trafikut. Gjë që në shumë raste u merr jetën.

Edhe në rastet kur një fëmijë qëndron në trotuar, asnjëherë nuk duhet të jemi të sigurt që ai nuk do të dalë në rrugë. Vizioni i fëmijëve nuk është shumë i zhvilluar dhe si rregull atij i duhet më shumë kohë që të orientohet në situatat e trafikut në mënyrë të sigurt.

Trajnimi i fëmijëve që në moshë të vogël do t'i shërbejë aftësitë e fëmijëve për të kuptuar më mirë rreziqet e rrugës (objektiv afatshkurtër). Ky trajnim është, në të njëjtën kohë, një investim afatgjatë sepse shërben si bazë për të rritur vetëdijen e tyre si të rritur.

Në këtë mënyrë ky trajnim përveç vlerave aktuale, është i orientuar edhe nga e ardhmja.

Është shumë produktive të orjetohejmë në edukimin e fëmijëve në kushtet e trafikut

Megjithëse fëmijët mund të kenë njohuri të përgjithshme për rregullat dhe për kushtet e trafikut, si sinjalet, shenjat e rrugës, rregullat rrugore etj., nuk ka asnjë garanci se ata janë të aftë për t'i përdorur ato si duhet kur janë vetëm në trafik. Kjo kërkon që procesi i të mësuarit të mbështetet me modele konkrete të sjelljes në trafik, të shoqëruara edhe me përgjigjet përkatëse të pyetjeve *si, pse* dhe *kur* një strategji ose sjellje e caktuar është e përdorshme dhe e vlefshme. Kjo do të thotë që për të rritur efektshmërinë e edukimit rrugor të fëmijëve është e rëndësishme që ai të bëhet i shoqëruar me veprimtari dhe me shembuj të shumtë praktikë. Kjo do të ndihmojë nxënësit të kuptojnë më mirë situatat e trafikut në të cilat ndodhen.

Edukimi për rritjen e sigurisë rrugore si dhe informacioni dhe fushatat në shërbim të tij, duhet të bazohen në njohuritë e duhura për shkaqet e aksidenteve dhe rrethanat në të cilat ato ndodhin dhe jo vetëm në rastet e shkeljeve të trafikut.

Rregullat e trafikut, shpesh herë shprehen në fjalë të përgjithshme. Kjo i bën ato të vështira për t'u kuptuar nga një përdorues i thjeshtë i rrugës, për rrjedhojë edhe për t'i zbatuar e për të shmangur aksidente të mundshme në situata konkrete në trafik.

Për këtë arsye është e domosdoshme që rregullat e trafikut dhe njohuritë që lidhen me të të shprehen në një gjuhë më të qartë e më të thjeshtë, për t'përfshirë në materialet mësimore, me qëllim edukimin e fëmijëve në këtë drejtim.

Fëmijet duhet t'i dinë rregullat, ose të paktën disa prej tyre. Por e rëndësishme është që të dihen ato rregulla që lidhen konkretisht me përdoruesin e rrugës në një kohë ose moshë të caktuar. Kështu, një fëmijë gjashtë ose shtatë vjeçar nuk është e nevojshme të dijë rregullat e qarkullimit të mjeteve motorike për shembull sinjalet e trafikut "mjete të rënda", me përjashtim të rasteve kur këto sinjale ndikojnë në sjelljen tuaj.

E rëndësishme është që ata të njohin apo identifikojnë sjelljet e veta.

Njriu nuk është në gjendje të bëjë gjithçka. Për këtë arsye, secili duhet të njohë kufizimet e tij, për të qenë në gjendje t'i plotësojë ato në rrugë e në forma të tjera.

Kështu, fëmijët kanë disa kufizime fizike dhe psikologjike që mund t'i vënë ata në vështirësi. Për shembull, kufizimi fizik i fëmijëve nuk i lejon ata të shohin trafikun, veçanërisht nëse ata ndodhen në buzë të trotuarit dhe në anë të rrugës ndodhen makina të parkuara.

Nuk mund të jete i konsoliduar nje sjellje nqs nuk mesojme femijet te identifikojne disa nga mjetet qe levizin ne rruge.

Përpara se të kalohet rruga, duhen gjykuar mirë automjetet që vijnë drejt nesh. Kjo do të thotë se duhet të njihet lloji i automjetit, shpejtësia dhe largësia nga ne etj. Kjo është e rëndësishme për marrjen e vendimit nëse duhet kaluar rruga apo jo.

E njejta gje duhet thene edhe per rruget dhe llojet e tyre.

Ndryshimet që ekzistojnë ndërmjet llojeve të ndryshme të rrugëve (autostrada, rrugët e ndryshme etj.) nënkuptojnë edhe sjellje të veçanta që dallojnë nga njëra tjetra, sipas sinjalizimeve: tabela, lloji i shtrimit të rrugës, vijat e bardha etj. Nëse këto shenja nuk janë të dallueshme si duhet, ato ndikojnë negativisht në sjelljen e kalimtarit.

Momenti ose perzgjedhja e kohes ne kalimet e rrruges, merr nje rendesi me vete.

Për të siguruar rrugën më të sigurtë për të kaluar në trafik, duhet të kemi parasysh stinët e vitit (stinët me shi, me diell), kohët e festave etj., të cilat ndikojnë në numrin e automjeteve në qarkullim dhe në sjelljen e drejtuesve të tyre. Kjo ka vlerë si për stinët ashtu edhe për ditët e muajit dhe të javës. Për shembull, ne duhet të shmangim orët më të rënduara të trafikut ashtu si nuk duhet të harrojmë se këto orë janë të ndryshme në vende, pjesë, ose zona të vendit ose qytetit.